REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 462/20
Datë/Datum. 10.07.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-20-442-1-1-1**

Sa i përket tenderit për "**Furnizim me Dokumente Shëndetësore – Receta për Institucionet Shëndetësore**"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"ERPO PRINT" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Tirana p.n.
(Adresa)
Gjakovë *50000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
044128697
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Erzen Pozhari
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
erpoprint@hotmail.com
(Adresa elektronike)

10.07.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë është publikuar në platformën e-prokurimit me datë 03.03.2020
Me datën 16.03.2020 është publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
Afati për dorëzimin e ofertave ka qene me datën 10.05.2020 në ora 14:00
Me datën 10.05.2020 është bërë hapja e ofertave dhe kemi pranuar Procesverbalin e hapjes së tenderëve
Me datën 22.05.2020 janë publikuar Njoftimi për Vendimin e AK-së si dhe Letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe pasuksesshëm nga AK në platformën e-prokurimit
Po me datën 22.05.2020 ju kemi dërguar kërkesë për qasje ne dokumente zyrtare pranë AK-së dhe po me këtë datë kemi pranuar përgjigjen se na është caktuar termini për në ora 15:00.
Me këtë datë në terminin e caktuar nga AK kemi realizuar qasjen ne dokumente zyrtare meqë rast jemi pajisur me dosjen e tenderit te OE te shpërblyer me kontrate dhe OE-ve te tjerë pjesëmarrëse ne këtë AP si dhe i kemi shikuar mostrat e dorëzuara nga OE e shpërblyer me kontrate
Me datën 26.05.2020 kemi deponuar pranë AK-së Kërkesën për ri-vlerësim
Me datën 04.06.2020 AK publikon Vendimin mbi Pezullimin e AP-së ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi
Me datën 05.06.2020 AK publikon Vendimet mbi Rishqyrtimin e Kërkesave për rishqyrtim të OE-ve
Me datën 11.06.2020 kemi pranuar nga AK – Letrën standarde për sqarimin e tenderit – Informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët
Me datën 15.06.2020 i jemi përgjigjur AK-së duke dhënë sqarimet e kërkuara nga AK me provat shkresore dhe bazën ligjore
Me datën 22.06.2020 kemi pranuar Vendimin e AK-së për shpërblimin me kontratë të OE "Blendi" si dhe Eliminimin tonë nga ky AP
Me datën 29.06.2020 kemi deponuar pranë AK-së prapë Kërkesë për ri-shqyrtim ndaj Vendimi te AK-së për eliminimin tone nga ky AP
Me datën 30.06.2020 AK ka publikuar Njoftimin për pezullimin e Aktivitetit të prokurimit
Me datën 01.07.2020 AK publikon Vendimin për refuzimin e Kërkesës sonë për ri-shqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	X				Jo		

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				Jo		

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me veprimet dhe/apo mos veprimet e veta ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht:
Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 1, 2 dhe 6.vi
Nenin 28 - Specifikimet teknike
Nenin 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Nenin 52 – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi
Nenin 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafin 1.1
Nenin 61 – Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
Nenin 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 2.1 dhe 2.4

Dhe dispozitat nënligjore nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe atë dispozitat:

Nenin 20 – Specifikimet Teknike
Nenin 26 – Kriteret e përzgjedhjes, paragrafët 1.2 dhe 26.8
Nenin 28 – Kriteret e dhënies së kontratës
Nenin 30 – Siguria e Ekzekutimit, paragrafin 4
Nenin 38 – Mostrat e Tenderëve
Nenin 41 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të ulët:

Nenin 3 – Informatat e përgjithshme, paragrafët 3.1.i, ii dhe iii
Nenin 4 – Procedura e shqyrtimit (inter partes), paragrafët 4.4.1, 4.4.2 dhe 4.4.3

Njoftimin e KRPP-së të datës 26.06.2020 në platformën elektronike të prokurimit, për sqarimin e dispozitave ligjore të LPP-së:
Neni 69 i LPP-së, paragrafi 4.2 – Aftësitë teknike dhe / ose profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK Ministria e Shëndetësisë me veprimet dhe/apo mos veprimet e veta ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi te cituara me larte ne këtë formular, duke na eliminuar pa drejtësisht dhe ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe vetë kriteret e përcaktuara nga AK ne FTD në ketë AP.

AK ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 01.07.2020. ka dhënë dy arsye për eliminim tonë nga ky AP, njëri për sipas AK-së. Mos plotësimin e kriterit 1 nga FTD si dhe për shkak të çmimeve jo-normalisht të ulëta për artikujt 2, 3, 5, 12, 13, 16 dhe 17.

Vlerësimi i AK-së se Nuk e kemi plotësuar kriterin – 1. *Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme ne vlerë se bashku jo me pak se 600,000.00 euro (Gjashtëqind mijë Euro). Në rast të grupit te OE (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar.*, me arsyetimin se nga anëtari i konzorciumit GRAF-TEK janë prezantuar vetëm Lista e furnizimeve dhe faturat kryesisht me subjekte private, e të cilat nuk i referohen kontratave pro vetëm shitjeve dhe nuk ka të bashkangjitur referenca siç është kërkuar ne DT. Sipas AK-së është kërkuar që të jenë furnizime për "projekte të ngjashme-kontrata" të realizuara me sukses dhe jo shitje të ngjashme. Kjo "logjikë" nëse mund të quhet e tillë, është për të ardhur keq për nivelin e intelektit të përdorur me ketë rast, është në KUNDERSHTIM me dispozitat e Kodit Etik të Prokurimit Nenin 3.3 dhe 7.2, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 si dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nenin 69.2 dhe 69.2.1, Nenin 51.1 si dhe Nenin 26.1.2 dhe 26.8 të RRUOPP-së, sepse AK nuk mund të insistoj, as nuk e ka ne vullnetin e saj të lirë të marrë për bazë apo jo, ti aplikoj apo refuzoj dispozitat ne fjalë, sepse ato janë dispozita imperative dhe jo-fakultative dhe e obligojnë AK-në që dëshmitë e prezantuara nga OE GRAF-TEK për furnizime të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit, të prezantuara me klientë qofshin ata privatë apo publikë, ti pranojë dhe ti marrë për bazë, përderisa ato janë të dëshmuara me prova apo dëshmi në harmoni me këto dispozita ligjore. Ne nenin 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Paragrafin 2.1 sqarohet kjo situatë shumë qartë dhe shkronja të shtypit, si vijon:

Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:

   2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

Kjo çështje edhe më tutje sqarohet edhe nga Interpretimi i KRPP-së i datës 26.06.2020 i publikuar ne platformën e prokurimit publike si sqarimi Nr. 74, për interpretimin e drejtë dhe të saktë të Nenit 69, paragrafit 4.2 të LPP-së, për Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht Listën e kontratave dhe dëshmitë e bashkangjitura kësaj liste, siç është rasti konkret, ku ndër tjerash në ketë interpretim sqarohet se si duhet vepruar dhe vlerësuar kontratat e realizuara dhe për provueshmërinë e dokumenteve kur kemi të bëjmë me blerës privat:

4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: **(ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;**

Bazuar ne Nenin 51.1, në asnjë rast AK nuk duhet të përfshijë, saktësoj ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji (LPP-së). Pra AK nuk mund të përdorë kritere të tjera përveç siç e parasheh ligji dhe DUHET ti përmbahet Nenit 69.2.1 të cekur dhe ilustruar më lartë.

Kjo çështje sqarohet dhe interpretohet edhe më qartë dhe më saktë ne Nenin 26 të RRUOPP-së, si vijon:

26. Kriteret e Përzgjedhjes

26.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

*1) Një OE **vërteton të jetë i** përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe*

*2) Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar **kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla** dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.*

Siç edhe mund te lexohet, ai që dëshiron ta lexoj dhe kuptoj, sqarohet dhe është e qartë se këto norma ligjore janë imperative dhe urdhëruese, sepse fjalia "***një OE do të konsiderohet i kualifikuar***" nuk lenë hapësirë që AK sipas vullnetit të lirë të vendos se si të veproj, por gjithnjë duke u bazuar në këto dispozita. Aty sqarohet se nëse OE dëshmon duke ofruar dëshmi sipas neneve 64 deri në 69 të LPP-së, për kërkesa minimale për kualifikim, kjo **OE DO TË KONSIDEROHET I KUALIFIKUAR.**

Gjithashtu ne Nenin 26.8 të RRUPP-së sqarohet shumë qartë se cilat kritere të përzgjedhjes mund të përdoren nga AK. Aty askund nuk specifikohet as shprehimisht e as nuk jepet për të kuptuar, as sipas logjikës së AK-së apo ndonjë logjike tjetër, se nëse OE nuk prezanton "Referenca" me po këtë titull të dokumentit, do të eliminohet nga konkurrenca. Lusim AK që ta lexoj këtë kriter me vëmendje:

3. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale	***Në rast të kontratës për furnizim të produkteve:***	a. Një listë që liston furnizimet kryesore relevante të OE që specifikon: produktet e përfshira, shumën kontraktuale, datën dhe pranuesin / certifikata e pranimit
	a. Vlera minimale në lidhje me furnizimet në 3 vitet e fundit	
	b. Kërkesat minimale të mundësive teknike të OE	b. Përshkrim i mundësive teknike të OE

si dhe sqarimin e dhënë në faqen 64 të RRUOPP-së:

Shënim për kërkesat e aftesise teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):

- *Në përputhje me ligjin e prokurimit publik, AK mund te kërkoj nga OE **një listë te projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit.** Kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi*
  - (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. Te gjitha këto dëshmi duhet te kenë vlerën e realizuar.
  - *(ii)* kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

Nga sa u tha më lartë, jo nga fjalët tona si OE, por nga dispozitat ligjore dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik ne Kosovë, dëshmitë e prezantuara nga grupi i OE, përkatësisht anëtari i grupit, kompania GRAF-TEK, janë plotësisht ne harmoni me dispozitat ligjore dhe kriteret e përcaktuara nga AK, duhet të merren për bazë nga AK dhe të konsiderohet pa asnjë fije dyshimi se kriteri ne fjalë nga FTD është plotësuar nga ky grup i OE-ve. OE ERPO PRINT si dhe OE GRAF-TEK si grup kanë prezantuar dëshmi për shitje të produkteve të njëjta apo të ngjashme me një shumë totale prej gjithsejtë 780'434.29€. Me këtë rast, ky kriter është plotësuar dhe i njëjti DUHET të pranohet si i tillë nga AK dhe nga të gjithë të tjerët, përderisa bazohen dhe punojnë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu është për tu habitur fakti, se si AK shkelë me të "dyja këmbët" Nenin 7 të LPP-së, me rastin e dërgimit të Kërkesave standarde për sqarimin e tenderit dy OE-ve të tjerë për sqarimin e "Referencave" dhe Faturave të shitë-blerjes së mallit, përkatësisht OE Mediatech & Printy sh.p.k. dhe Europrinty si dhe OE N.T.SH. Litografia dhe N.T. Agimi De, për sqarimin e faturave të shitjeve me blerës privat se sipas AK-së duhej sqaruar para se të konsideroheshin si të pranueshme, ndërsa Faturat e prezantuara nga ne (anëtari i grupit GRAF-TEK) nuk kanë fare nevojë as të sqarohen sipas Nenit 72 të LPP-së dhe Nenit 26.8 të RRUOPP-së, por mjafton që të shpallen si të pa pranueshme. Veprime këto edhe në kundërshtim me Kodin Etik të Prokurimit.

Gjithashtu vlen të ceket se AK përdorë termin "***Projekt***" për ta arsyetuar veprimin e vetë të kundërligjshëm, se kinse OE GRAF-TEK ka bërë shitje me blerës kryesisht privatë dhe nuk ka përfunduar projekte të natyrës së ngjashme, siç ka kërkuar AK. Por AK duhet ta ketë parasysh se këtu kemi të bëjmë me furnizim sepse kodi i prokurimit përveç tjerash e sqaron ketë. Pra në rastin konkret, ku kemi të bëjmë me furnizim, pra shitje nga ana e OE e jo shërbime apo punë, fjala projekt është ndër fjalët më të gabuara dhe të pavend që mund të përdoren, sepse kjo fjalë nënkupton: "***një pjesë e punës ose veprimtarisë së planifikuar që përfundon gjatë një periudhe kohe dhe synon të arrijë një qëllim të veçantë: një projekt kërkimor, projektet e ndërtimit...***" pra ka të bëjë me punë apo veprimtari dhe jo me shitë-blerje, për çka edhe ka të bëjë ky AP. Propozojmë të përdorim fjalë të cilave ja u njohim kuptimin.

Gjithashtu AK ka "konstatuar" se kemi ofruar tender jo-normalisht të ulët për artikujt e cekur më lartë dhe atë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, Nenin 61, paragrafin 2 dhe 3, si dhe Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët Nenin 3 paragrafin 1 dhe Nenin 4 paragrafët 4.4.1, 4.4.2 dhe 4.4.3, sepse ndonëse AK ka ngritur dyshimin se kemi ofertuar me tenderë jo-normalisht të ulët, ne me datë 15.06.2020 i kemi sqaruar AK-së mënyrën e vendosjes së çmimeve, kalkulimet si dhe procesin e prodhimit dhe të kostos së prodhimit duke e sqaruar me përpikëri se përse këto janë çmime reale dhe se si kemi arritur në këto çmime. Gjithashtu i kemi propozuar AK-së se nëse ende ka dyshime se nuk do të mund të ekzekutojmë kontratën, se AK ka merakun tonë se nuk mund të ja dalim, bazuar ne Nenin 30, paragrafin 4 të RRUOPP-së, ta ngritë vlerën e Sigurimit të Ekzekutimit nga 10% në 20% të vlerës së kontratës, duke i garantuar kështu AK-së se kontrata do të ekzekutohet në tërësi dhe me përpikëri nga ane e jonë.

Ne konsiderojmë se ky konstatim nuk qëndron dhe i njëjti konstatim është ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi, bazuar ne Nenin 61 të LPP-së Nr. 04/L-042, Nenit 42 të RRUOPP-së si dhe Nenin 3 të Rregullores për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët B57, sepse kriteret e parapara për tu plotësuar për tu konsideruar si tender jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 3.1 të Rregullores B57 e as sipas paragrafit 3.2 nuk janë plotësuar.

Shih me poshtë kushtet e parapara ne Nenin 3 të Rregullores për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët B57:

Neni 3
Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen **të gjitha kushtet e mëposhtme:**

i. çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 **(tre) tenderë**.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregulave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe mjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Përveç tjerash as bazuar ne Nenin 3.2 e as sipas shembujve të dhënë të Rregullores B57 nuk janë dhënë as shembuj as rregulla e as kushte apo kritere konkrete të cilat eventualisht do të duhej të merreshin si shembuj, sepse Nenin 3.2 përcakton për rastet e pa parashikuara ne paragrafin 1 të Nenit 3 të merren për bazë paragrafët e mëposhtëm, por as ne ato paragrafë nuk janë plotësuar kushtet për tu konsideruar si tender jo-normalisht i ulët.
Krahasimet e bëra nga AK lidhur me dallimet ne çmime në mes të artikujve të ofruar nga ne, të cilët i ka konsideruar si jo-normalisht të ulët, me arsyetimin se kemi të bëjmë me artikuj të njëjte, nuk qëndrojnë dhe atë për arsyet si më poshtë:

Dallimi ne çmimin e ofruar ne mes të artikujve Nr. 1, 2 dhe 3, ndonëse kemi të bëjmë me artikullin Receta...., Bllok 1x100, qëndron ne sasinë e paraparë për tu blerë nga AK, përkatësisht për tu prodhuar nga OE, ku dallimi esencial ne çmimin e ofertuar qëndron tek procesi i prodhimit, përkatësisht stafi i angazhuar ne ketë proces.
Për prodhimin e artikujve Nr. 2 dhe 3 me sasitë e parapara për 24 muaj, nuk kemi nevojë ne si OE të angazhojmë staf profesional apo shtesë dhe as ti ndalim apo pauzojmë proceset e rregullta të prodhimit sepse këta artikuj me këto sasi do të prodhoheshin gjatë orarit të rregullt nga vetëm një i punësuar, i cili nuk duhet të jetë fare profesional, me një makinë shumë të thjeshtë të shtypit, pa qenë fare nevoja për shpenzime të larta as për nga procesi i prodhimit e as për pagesat e stafit. Ndërsa për prodhimin e Artikullit Nr. 1, me sasinë e parashikuar për 24 muaj, përveç se stafi i angazhuar për ketë proces të prodhimit është i përberë nga disa persona, të gjithë profesionist specifik të lamisë përkatëse, kosto e të cilëve është deri në 4 herë më e lartë se sa e stafit bazik i cili merret me prodhimin e sasive të vogla, edhe procesi i prodhimit ne fjalë ka kosto shumë herë më të lartë. Kjo për disa arsye shumë të thjeshta: përgatitja para shtypit/printit, përgatitja e filmave për incizimin e pllakave të shtypit, prodhimi i pllakave të shtypit, procesi i para shtypit dhe përgatitja e makinës për fillimin e shtypit, materiali shpenzues deri në fillimin e shtypit të produkteve finale (makllaturave), kosto e energjisë elektrike të cilat makina shpenzojnë deri në 10 herë më tepër energji elektrike se sa makinat e vogla të shtypit të cilat i përdorim për shtypin e sasive të vogla dhe shpenzime e kosto të tjera nga procesi i prodhimit, të cilat edhe e bëjnë diferencën në koston finale të produktit. Pra kjo diferencë vjen si rezultat i procesit të prodhimit dhe politikave zhvillimore të kompanisë sonë dhe grupit të OE-ve pjesëmarrëse në ketë AP.

E njëjta vlen edhe për artikujt e potencuar nga AK, Nr. 5, 6, 7, 8, 9 si dhe artikujt 12, 13 dhe 14 edhe për artikujt 15, 16 dhe 17, ku procesi i prodhimit dhe stafi i angazhuar ne këtë proces të prodhimit, e benë diferencën e kostos së prodhimit dhe rrjedhimisht çmimin final të produktit. Edhe OE-të tjerë, ka ofruar me "logjiken" e njëjte të kalkulimit të çmimeve, përkatësisht duke u bazuar ne procesin e prodhimit dhe zgjidhjet teknike të cilat i disponojnë, meqë rast kemi dallimin ne çmimet e ofruara, varësisht nga sasitë e parapara për tu prodhuar.
Nga krahasimi i ofertave të OE-ve pjesëmarrëse në këtë AP, vërtetohet se dallime kanë të gjithë ofertuesit në mes të çmimeve të artikujve të ofertuar, varësisht nga sasia për secilin artikull veç e veç, meqë rast këto çmime përcaktohen nga procesi i prodhimit. Dhe këto dallim në mes të OE-ve varen nga makineria specifike që secili disponon dhe përdorë për proceset e prodhimit, stafi dhe kualifikimit e tyre si dhe shpenzimet ne paga dhe mëditje, procesi i automatizimit, etj. dhe politikave të kompanive se ne cilët drejtime kanë fokusin të zhvillohen dhe interesat e tyre për ta caktuar pragun e profitit që duan të arrijnë.

AK ka vepruar edhe ne kundërshtim me vetë Shembujt e dhënë tek Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, ku sqarohet qartë se si duhet vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet për tu vlerësuar ndonjëri nga tenderët si jo-normalisht i ulët. Shih më poshtë shembujt dhe konkluzionet e dhëna:
Shembulli 1:

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Eshtë plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet	

Shembulli 2:

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se **3 oferta**	Eshtë plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta.
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Asnjë oferte nuk plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me pak se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
Konkludim	Asnjë oferte nuk mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet sipas paragrafit 3.1 por AK mund te vazhdoj sipas paragrafit 3.2 te rregullores	

Nga sa u vërtetuar nga faktet e paraqitura më lartë, vjen në konsideratë alternativa e vetme, përkatësisht Neni 61, paragrafi 3, ku pas këtyre sqarimeve dhe informacioneve të dhëna nga ne, tenderi ynë duhet trajtuar njëjte me çdo tender tjetër të përgjegjshëm në këtë AP dhe si i tillë të konsiderohet si i kualifikuar dhe i përgjegjshëm, me çmimin më të lirë të ofruar.

Është për tu habitur fakti se si AK e vlerëson VETËM ofertën e OE Blendi si ofertë të balancuar dhe me çmime reale – pa ndryshime të theksuara ne mes të artikujve të njëjtë dhe se si e tillë është nuk përmban çmime jo normalisht të ulta. Ku e gjen guximin AK të lëshohet ne vlerësime dhe veprime të tilla, kur mirëfilli dihet se për këtë vlerësim duhet të jenë së paku 3 oferta të përgjegjshme dhe krahasimet të bëhen në mes tyre dhe jo në mes të çmimeve të ofruara nga

vetëm një kompani. Bazuar ne cilën formulë matematikore, shkencore apo analitike ka arritur vallë AK në ketë përfundim? Cilët sipas AK-së janë çmime reale, që i paska ofruar një OE e vetme? Reale krahasuar me çka? Apo ndoshta ofertuesit e tjerë e kanë keqkuptuar kriterin e vendosur nga AK, "çmimi më i lirë" e në fakt ka pasur kuptimin e "çmimit më të shtrenjtë" për tu konsideruar "reale" nga AK, ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi dhe pas as edhe një bazë të vetme ne ligjet, rregulloret, Udhëzimet Administrative apo çfarëdo baze tjetër çfarëdo çoftë ajo.

AK gjithashtu ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, Nenin 28 dhe 69 paragrafin 2.4 si dhe Nenin 20 dhe 38 të RRUOPP-së dhe kriteret e vendosura nga vete AK ne FTD te dosjes se tenderit ne fjale, konkretisht ka pranuar mostrat e OE Blendi shpk ndonëse ato NUK JANE ne harmoni me Aneksi 1 - Specifikimet teknik te detyrueshme të hartuar nga AK, artikujt - pozicionet Nr. 4, 6, 8, 9 dhe 17, dmth. 30% e mostrave të prezantuara nga OE Blendi nuk janë në harmoni me specifikacionin teknik të DETYRUESHËM, për çka edhe është eliminuar një OE tjetër nga konkurrenca në ketë AP.
Nga mostrat e prezantuara nga OE Blendi, mund të konstatohen dallime të qarta se këto mostra janë në kundërshtim me Specifikacionin Teknik të Detyrueshëm dhe atë si vijon:

1. Urdheresë për dhënjen e terapisë parenterale
Formati 21x29.7cm, 1 fletë
Letra e bardhë HW-155IC offset 80gsm
Shtypi njëngjyresh, **njëaneshem** me numeracion
VËREJTJE: Është e shtypur (printuar) dyanshëm, me çka nënkuptohet se në vend që të furnizohen gjithsejte 3'003'180 copë fletëza do të furnizoheshin vetëm 50% i sasisë pra vetëm 1'501'590 copë fletëza (fleta), sepse kështu do reduktohej sasia e letrës së një formulari dhe rrjedhimisht AK do të dëmtohej me një total prej 15'015.90€ bazuar ne ofertën e OE Blendi shpk.

6. Raport kthyes nga diagnostika
Formati 21x29.7cm bllok 100 fletë
Letra e bardhë HW-155IC offset 80gsm
Shtypi një ngjyrëshe i njëanëshem
VËRETJE: Ky artikull NUK duhet të ketë numracion apo numër serik sepse është specifikuar si i tillë, ndërsa artikujt të cilët duhet të kenë numëracion është kërkuar shprehimisht nga AK. OE Blendi shpk i ka vendosur numër serik në kundërshtim me specifikimet teknik të detyrueshme.

8. Udhëzim për konsultim
Formati 21x29.7cm bllok 100 fletë
Letra e bardhë HW-155IC offset 80gsm
Shtypi një ngjyrëshe, **i dyanëshem**
Faqja e dytë është Raporti nga Konsulta (shif ne vazhdim)
VËREJTJE: Është e shtypur (printuar) një anshëm, ndërsa shumë qartë është kërkuar shtyp i dyanshëm si dhe OE Blendi i ka vendosur edhe këtu numeracion apo numër serik në kundërshtim me specifikimet teknik të detyrueshme. Edhe kjo mostër nuk e plotëson kriterin e kërkuar dhe specifikimin e detyrueshë, për çka është eliminuar një OE tjetër nga procesi i tenderimit.

9. Raport nga konsulta
Formati 21x29.7cm bllok 100 fletë
Letra e bardhë HW-155IC offset 80gsm
Shtypi një ngjyrëshe,
VËRETJE: Ky artikull NUK duhet të ketë numracion apo numër serik sepse është specifikuar si i tillë, ndërsa artikujt të cilët duhet të kenë numëracion është kërkuar shprehimisht nga AK. OE Blendi shpk i ka vendosur numër serik në kundërshtim me specifikimet teknik të detyrueshme.

17. Fletëza Kompjuterike e të Posalindurit (SISH-003)
Formati 21x29.7cm bllok 100 fletë
Letra e bardhë HW-155IC offset 80gsm
Shtypi një ngjyrëshe, i dyanëshem, me numeracion
VËREJTJE: Është e shtypur (printuar) një anshëm, ndërsa shumë qartë prap edhe këtu është kërkuar shtyp i dyanshëm. Edhe kjo bie në kundërshtim me specifikimet teknik të detyrueshme dhe jo rastësisht janë të emërtuara si specifikime teknike të detyrueshme, sepse si të tilla duhet të plotësohen nga OE i rekomanduar për kontratë.

AK me rastin e eliminimit të tenderit tonë, ka shkelur gjithashtu edhe Nenet 52.1, 59.2 dhe 60.1.1 duke e shpërblyer me kontratë një OE me çmimin shumë më të lartë se çmimi i ofruar nga ne, ne kundërshtim me kriterin për shpërblimin me kontratë.

Nga sa u tha më lartë, duke u bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara më lartë dhe dëshmitë e bashkangjitura kësaj kërkese, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e akteve nënligjore, kërkojmë nga OSHP që ofertën e OE Blendi të shpërblyer me kontratë ta shpallë si jo të përgjegjshme, ta eliminoj OE në fjalë dhe rrjedhimisht të na shpërblej ne me kontratë, si grup i OE-ve të përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmi i shkaktuar nga AK është relativisht i madhe, i cili mbetet të sqarohet në terë në procedurat e mëvonshme, por deri më tani të identifikuar janë si vijon:
Fitimi eventual i humbur: 108'265.00€
Shpenzimet e përfaqësimit: 1'500.00€
Dëmtim i imazhit të kompanisë: 24'600.00€, etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
b) *një kopje të platformës së e-prokurimit me data e publikimit të dokumenteve*
c) *Një kopje të Njoftimi për informata shtesë ose Përmirësim i gabimit*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve*
e) *Kopje nga platforma elektronikë e prokurimit për dërgimin e njoftimit nga AK për eliminimin tonë i datës 22.06.2020*
f) *B42 – Letër standarde për tenderuesin / kandidatin e eliminuar i datës 22.06.2020 duke na eliminuar nga ky AP*
g) *një kopje të publikimit të Njoftimit B58 – Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 22.06.2020*
h) *B45 – Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm i datës 22.06.2020 duke e shpërblyer kontratë OE blendi*
i) *Kopje e Neneve të LPP-së, Neni 69, 51, 61, 59, 60, 52 dhe 7*
j) *Kopje e Neneve të RRUOPP-së, Neni 26.1, 26.8, faqe 58, faqe 64,*
k) *Kopje të Rregullores për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët B57 me shembujt e ilustruar*
l) *Kopje të Raportit të rivlerësimit të tenderëve, 3 faqe*
m) *Kopje e Vendimit për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim të dates 22.06.2020*
n) *Vendimin për shpërblimin me kontratë të OE Blendi shpk*
o) *Kopje të mostrave të prezantuara nga OE Blendi shpk, Art. Nr. 4, 6, 8, 9 dhe 17*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*